



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data

16.7.2021

Lënda: Kërkesë për informacion

Nr. Protokolli

6092

DREJTUAR: KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

KËSHILLIT TË BASHKISË DURRËS

Sheshi "Liria", nr. 15, Durrës

Për Dijeni: INSTITUTIT SHQIPTAR TË SHKENCAVE

Adresa: Rruga "Asim Vokshi", pallati 13/25, kati 3, Tiranë

Të nderuar,

Nëpërmjet shkresës nr. 5613 prot., datë 02.06.2021, Instituti Shqipëtar i Shkencave ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një denoncim, mbi bazën e të cilit pretendon se "Qeveria Qendrore ka krijuar një Fond në vlerën 926 449 664 lekë, për Bashkinë Durrës, në data të fushatës zgjedhore pa Akt Normativ dhe Ligj".

Referuar nenit 3, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, parashikohet se:

"Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë."



Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj një informacion të detajuar, për sa pretendohet nga denoncuesi brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijani e kësaj shkrese.

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë denoncimin e depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nr. 5613 prot., datë 02.06.2021, të Institutit Shqipëtar të Shkencave.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

